



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, neni 52 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe neni 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbal i **MBLEDHJES SË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, KOMUNA SKENDERAJ**, i datës **20.05.2026**, ora **10:00**

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, (raporton Drejtori i DKA-së, z. Kastriot Duraku);
4. Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Komunitete,(raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija);
5. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Përshëndetje për të gjithë, të pranishëm në mbledhje i kemi 5 anëtar, mungon me arsye Afrim Kabashi, ndërsa mungon pa arsye Hysni Mehani, vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës e hapi diskutimin pasi që nuk ka për diskutim, shkojmë me votim, konstatojmë se me 5 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendit i ditës, vazhdojmë me piken e radhës Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, raporton Drejtori i DKA-së, z. Kastriot Duraku.

Kastriot Duraku, DKA –Faleminderit Kryesuese, të nderuar anëtar të kpf, koleg drejtor, para jush keni rregulloren për Institucionet Edukativo- Arsimore në Komunën e Skenderajt, e cila ka qene ne diskutim 17 ditë, gjate kësaj periudhe komisioni ka pranuar kërkesa sugjerime, ato te cilat kane qene te arsyeshme e te nevojshme i kemi përfshi në rregullore, qëllimi i kësaj rregulloreje është ti përcaktoj kjarte sjelljet dhe obligimet e nxënësve, mësime dhënëse dhe personelit edukativo arsimor dhe stafit mbështetës konkretisht fokus te veçantë ka qene pjesa masat e nevojshme ndaj sjelljeve jo te mira te nxënësve te nivelit 6 deri 9 veçanërisht masa vetdijesuese, kjo rregullore

është hartuar bazuar ne legjislacionit ne fuqi, rregulloren e MASHT, unë nuk po e zgjati me shumë sepse te gjitha veç i keni ne rregullore, mirëpo nëse keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Drejtor, e hapi diskutimin për këtë pikë të rëndit të ditës.

Aferdita Pllana – Rama, PDK – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë kam një kërkesë apo sugjerim qe ne çerdhet tona, te ketë të angazhuar ndonjë mjeke i përgjithshëm apo pediatër jo secila çerdhe mirëpo disa çerdhe një mjeke apo pediatër, sepse rastet kur fëmijët ne këto çerdhe kanë probleme shëndetësore, edukatoret nuk mundën me i konstatua këto probleme shëndetësore te fëmijëve e ne këtë mënyrë na u përhapen edhe te fëmijët tjerë këto probleme shëndetësore, pastaj rastet tjera janë kur nxënësit na i sjellin nga shkolla per trajtim ne QKMF vijën te shoqëruar nga vete nxënësit e qe do duhet ti sjell ndonjë arsimtar i edukatës fizike apo kujdestar klase e jo nga vete nxënësit sepse mandej po kemi problem edhe kur pe bëjmë raportin ne, andaj ti njoftoni edhe drejtorit e shkollave për këtë gjë, faleminderit.

Kastriot Duraku, DKA – Drejtoresh faleminderit për këto kërkesa qe i paraqite, për angazhim te mjekëve apo pediatërve ne çerdhet tona, me herët kemi hapur konkurse mirëpo nuk ka pasur te interesuar për aplikim sepse nuk kompensohen për punën qe e bëjeni , kemi menduar qe te lidhem ndonjë kontrate për trajtime te rasteve leukopedike te rasteve qe na u paraqiten ne bazë te tretmanëve qe bëhen edhe ti paguajmë, ndërsa për rastet e nxënësve qe sjellën nga nxënësit për ndonjë trajtim ne Qkmf ne i kemi njoftuar drejtorit e shkollave se duhet te sjellën nga arsimtari i lendes ose kujdestari i lendes mirëpo prapë do ti njoftojmë qe te jene te kujdesshëm për këtë çështje.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit drejtor, pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 5 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim rekomandohet për Kuvend Propozim për miratimin e Projekt – Rregullores për Institucionet Edukativo - Arsimore në Komunën e Skenderajt, vazhdojmë me piken e 4 të rëndit të ditës Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares se Komitetit për Komunitete, për këtë pikë raportoj unë propozimi ne fjale ka te beje me zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete znj Albina Arifi nga komuniteti boshnjak e cila ka kërkuar te zëvendësohet për shkake se e cila do te jeton jashtë Kosovës e qe komiteti për komunitete ne mbledhjen qe kanë mbajtur kane kërkuar me rekomandim zëvendësimin e saj me anëtarin Iso Nazufi nga i njëjti komunitet e për shkake te kuotës gjinore ne i kemi kërkuar qe këtë zëvendësim ta bëjnë me anëtares e te njëjtës gjini, mirëpo te cilët na kane thënë se nga gjinia femërore nuk kemi te interesuar për të qenë pjese e komitetit për komunitete andaj me kërkesë të tyre ju kërkojë qe ta rekomandojmë për Kuvend këtë propozim – vendim, e hap diskutimin për këtë pikë të rëndit të ditës, pasi qe nuk ka për të diskutuar, shkojmë në votim, konstatojmë se me 5 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim rekomandohet për Kuvend Propozim – Vendim për zëvendësimin e anëtares se Komitetit për Komunitete, vazhdojmë me piken e radhës ne të ndryshme e hap diskutimin, pasi qe nuk ka për diskutuar, ju falënderoj për pjesëmarrje me kaq e mbylli këtë takim, ju faleminderit.

Procesmbajtësi

